



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

***Komisioni për Politikën e Jashtme***

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 02.07.2018, ora 12:00

**Drejton mbledhjen:**

**Mimi Kodheli – kryetare e Komisionit**

**Rendi i ditës:**

1. Seancë dëgjimore me Elida Petoshatin - kandidate për Ambasadore e Jashtëzakonshme dhe Fuqplotë e Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Danimarkës;

Donika Hoxhën - kandidate për Ambasadore e Jashtëzakonshme dhe Fuqplotë e Republikës së Shqipërisë në Republikën e Bullgarisë, rezidente si dhe Ambasadore e Jashtëzakonshme dhe Fuqplotë e RSH-së në Republikën e Moldavisë, jorezident;

Ridi Kurtezin - kandidat për Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqplotë i Republikës së Shqipërisë në Republikën e Malit të Zi

2. Çështje të tjera

**Marrin pjesë:**

Mimi Kodheli, Elona Hoxha, Andrea Marto, Vasilika Hysi, Evis Kushi Klotilda Bushka, Klajda Gjoshaj, Ervin Bushati, Ilir Xhakolli, Xhemal Qefalia, Edmond Panariti

**Mungojnë:**

Tritan Shehu, Eglantina Gjermeni, Nard Ndoka, Rudina Hajdari, Klevis Balliu, Edi Paloka, Adnor Shameti.

**Të ftuar:**

Gazmend Barbullushi - Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme.

## HAPET MBLEDHJA

**Mimi Kodheli** – Mirëdita të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Politikën e Jashtme të datës 02. 07. 2018.

Në rend dite kemi seancë dëgjimore me zonjën Elida Petoshati, kandidate për Ambasadore e Jashtëzakonshme dhe Fuqiplotë e Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Danimarkës; zonjën Donika Hoxha, kandidate për Ambasadore e Jashtëzakonshme dhe Fuqiplotë e Republikës së Shqipërisë në Republikën e Bullgarisë, rezident, si dhe Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë i Republikës së Shqipërisë në Republikën e Moldavisë, jorezidente, si dhe zotin Ridi Kurtezi, kandidat për Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë i Republikës së Shqipërisë në Republikën e Malit të Zi. Kandidatët i shoqëron zoti Barbullushi, i cili është sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme.

Mirë se keni ardhur, zotërinj!

Zoti sekretar, fjala është për ju, besoj që ju do të bëni prezantimin, dhe më pas do të dëgjojmë çfarë kanë kandidatët për të ndarë me Komisionin e Politikës së Jashtme.

Ndërkohë, për sqarim, sistemi i ri i videofonisë është akoma në testim, ndaj nuk ju rekomandoj ta përdorni.

Faleminderit!

Zoti Barbullushi, fjala është për ju.

**Gazmend Barbullushi** – Faleminderit, zonja kryetare!

E nderuar zonja kryetare,

Të nderuara zonja dhe zotërinj deputetë,

Më lejoni që në emër të Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme të prezantoj sot para jush tre kandidatë për ambasadorë: zonjën Donika Hoxha, zonjën Elida Petoshati dhe zotin Ridi Kurtezi.

Zonja Donika Hoxha është propozuar të jetë ambasadore e jashtëzakonshme dhe fuqiplotë në Republikën e Bullgarisë, rezidente dhe njëkohësisht në Republikën e Moldavisë.

Është pjesë e shërbimit të jashtëm prej vitit 1999 dhe ka shërbyer disa herë në përfaqësitë tona jashtë shtetit, si dhe në aparatën e Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme. Prej 3 vjetësh mban postin e rëndësishëm të Drejtorit të Drejtorisë për Diplomaci Ekonomike, Publike dhe diasporës, ku ka treguar angazhim dhe përkushtim. Mban gradën personale “Këshilltare”, ka kryer master për diplomaci, MAD, është doktoruar në Histori dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare në Universitetin La Sapienza në Romë, flet anglisht, frëngjisht dhe italisht.

Me Bullgarinë, vend mik e fqinj, anëtar i NATO-s dhe BE-së, kemi marrëdhënie tradicionale shumë të mira, të gjithanshme, të cilat është e nevojshme të thellohen edhe më tej në të gjitha aspektet.

Bullgaria e ka asistuar Shqipërinë gjatë gjithë procesit të anëtarësimit në NATO dhe në integrimin europian të vendit. Sapo ka përfunduar kryesinë e radhës të Këshillit të BE-së, ku luajtur një rol të spikatur për perspektivën e zgjerimit dhe çeljen e negociatave për Shqipërinë dhe Maqedoninë. Me mjaft rëndësi në këtë vend shikojmë edhe praninë e diasporës së hershme.

Për sa i takon Moldavisë, presim që ambasadori ynë një vitalizim të metejshëm të marrëdhënieve me këtë vend.

Gjykojmë që zonja Donika Hoxha është kandidate që i përmbush më së miri kriteret për të qenë përfaqësuesi ynë më i lartë në këto vende. Zonja Hoxha propozohet për herë të parë në postin e ambasadores. Nëse ju do t'i jepni besimin, do të kemi për herë të parë një grua në këtë post.

Zonja Elida Petoshati paraqitet pranë jush si kandidate për ambasadore në Mbretërinë e Danimarkës, në Kopenhagen. Bën pjesë në shërbimin e jashtëm që prej vitit 1998 dhe mban gradën personale “Ministër/këshilltar”. Ka mbaruar studimet e larta për gjuhë dhe letërsi frënge. Është doktoruar në Universitetin e Bukureshtit dhe mban titujt “Doktor i Shkencave në Studime Filologjike” dhe “Profesor i Asociuar”. Flet disa gjuhë të huaja, si: anglisht, frëngjisht, rumanisht, spanjisht dhe italisht. Në shërbimin e jashtëm ka dhënë kontribut të spikatur në disa poste me rëndësi, si drejtoreshë dhe koordinatorë ndërkombëtare. I është besuar dhe ka kryer me sukses detyrën e ambasadorit në Kanada në vitet 2011-2016. Aktualisht është e ngarkuar në detyrën e drejtoreshës së Marrëdhënieve Rajonale Politike.

Me Danimarkën kemi marrëdhënie të konsoliduara miqësie. Ky vend është anëtar i NATO-s dhe i BE-së dhe na mbështet në integrimin europian të vendit. Na ka mbështetur me projekte konkrete dhe mbështetje financiare në periudhat tona të tranzicionit.

Ndër të tjera, vlerësojmë të rëndësishëm fuqizimin e dialogut në të gjitha nivelet me këtë vend, sepse kemi nevojë të prezantojmë intensivisht dhe siç duhet progresin e reformave. Danimarka brenda Unionit hyn te grupi i vendeve që kërkonin rekorde e tregues konkretë të avancimit tonë në përmbushjen e pesë kriterëve integruese. Po aq e rëndësishme mbetet diplomacia ekonomike. Thithja e investimeve daneze, promovimi i markave shqiptare të prodhimit dhe turizmi do të duhet të jenë në fokusin e punës së ambasadores sonë, gjithnjë nëse.

Ne kemi besimin se kemi bërë zgjedhjen e duhur me zonjën Petoshati, e cila do t'i përmbushë me përkushtim detyrat e saj.

Po kaloj tani te zoti Ridi Kurtezi, i cili propozohet ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë në Republikën e Malit të Zi. Zoti Ridi Kurtezi është diplomuar në Moskë Për Marrëdhënie Ndërkombëtare, është bërë anëtar i shërbimit të jashtëm që prej vitit 1997, mban gradën personale "Ministër fuqiplotë". Ka marrë përsipër dhe ka kryer detyra të rëndësishme në aparatin e Ministrisë për Europën dhe Punët me Jashtë dy herë si drejtor Protokolli. Ka shërbyer disa herë në përfaqësi diplomatike, ku më parë ka qenë dy herë i besuar në postin e lartë të ambasadorit. Në vitin 2010 është dekretuar ambasador në shtetin e Katarit, kurse në vitin 2014 ka marrë detyrën si ambasador në Mbretërinë e Spanjës, detyrë të cilën po e ushtron aktualisht deri në dorëzimin e saj. Flet disa gjuhë të huaja, si: anglisht, rusisht dhe spanjisht.

Shqipëria e ka njohur menjëherë Malin e Zi, pas shkëputjes nga ish-Jugosllavia, dhe që prej këtij momenti marrëdhëniet me këtë fqinj të rëndësishëm janë zgjeruar mbi bazën e besimit reciprok dhe bashkëpunimit rajonal. Tregues domethënës është mbajtja e mbledhjeve të përbashkëta të qeverive, siç është parashikuar nesër, në datën 3 korrik, në Shkodër, ku është planifikuar të nënshkruhet një numër i konsiderueshëm marrëveshjesh.

Synimi ynë është që dialogu dhe bashkëpunimi shumë i mirë me këtë vend të ngrihet edhe më tej, në të gjitha nivelet, dhe të jetë shembull në rajon. Konkretisht, bashkëpunimi ndërkufitar meriton një vëmendje të veçantë.

Proceset integruese pasqyrohen më së miri në projektet e përbashkëta dypalëshe ose trepalëshe të mbështetura nga programi IPA, duke përfshirë këtu edhe Italinë, veç vendeve tona, natyrisht.

Shkëmbimet ekonomike me interes të përbashkët duhet të rrisin volumin e tyre. Në këtë aspekt, pa u shfrytëzuar mjaftueshëm ka mbetur konteksti shumë i mirë i marrëdhënieve politike që ne kemi.

Si objekt të rëndësishëm të punës së ambasadorit tonë në Malin e Zi shohim dhe do të mbetet faktori shqiptar, i cili qëndron në thelb të marrëdhënieve dypalëshe. Ky faktor duhet të ketë dhe të gëzojë vëmendjen e merituar.

Me zotin Ridi Kurtezi mendojmë se kemi paraqitur kandidatin e duhur qoftë për sa i takon eksperiencës, qoftë edhe përkushtimit ndaj detyrës që ai ka treguar në karrierën e tij.

Zonja kryetare e komisionit,

Të nderuar deputetë,

Ju falënderoj për vëmendjen tuaj në këtë prezantim të shkurtër të kandidatëve tanë për ambasadorë në vendet e përmendura!

Mbetem në dispozicionin tuaj për informacione dhe pyetje të tjera, së bashku me kandidatët për ambasadorë, të cilët janë prezentë në këtë mbledhje, qoftë edhe për të paraqitur idetë dhe objektivat e tyre në përmbushje të detyrave që u dalin, gjithmonë nëse ju do t'u jepni besimin tuaj!

**Mimi Kodheli** – Faleminderit, zoti Barbullushi!

Pa dashur të biem në përsëritje, lutem që zonjat e nderuara ambasadore dhe zoti ambasador (njëra për t'u bërë, tjetra që ka qenë dhe të bëhet përsëri), të gjithë me tituj të lartë të karrierës diplomatike, shumë shkurt të na thonë se cila është perspektiva, qasja e tyre në detyrën e re, në të cilën janë propozuar nga ministri i Punëve të Jashtme dhe Europën, zoti Bushati. Më pas e ftoj komisionin të bëjë pyetjet, nëse ka të tilla.

Kështu që, unë mendoj ta fillojmë me zonjën Petoshati.

Urdhëroni!

**Elida Petoshati** – E nderuar zonja kryetare,

E nderuar zonja zëvendëskryetare,

Të nderuara zonja dhe zotërinj deputetë,

Është privilegj i veçantë që më jepet mundësia të paraqitem para jush për të prezantuar disa nga drejtimit kryesore të misionit fisnik dhe detyrës me shumë përgjegjësi që më është propozuar për të shërbyer si ambasadore e Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Danimarkës.

Më lejon të skicoj në vija të përgjithshme në kuadrin e marrëdhënieve të marrëdhëniet me Danimarkën karakterizohen nga një miqësi e konsoliduar dhe bashkëpunim i orientuar nga vlerat e përbashkëta euroatlantike, partneriteti në NATO dhe mbështetja konstante ndaj rrugës europiane të Shqipërisë përbën dimensionin kyç të marrëdhënieve shqiptaro-daneze.

Danimarka renditet ndër vendet që kanë shoqëruar tranzicionin demokratik të Shqipërisë me asistencë të strukturuar, duke kontribuar në mirëqeverisje, në forcimin e kapaciteteve për institucionet shqiptare, fuqizimin e shoqërisë civile dhe mbështetjen ndaj të drejtave të njeriut.

Kontributi i sipërpërmendur përbën një ndihmesë të mirëfilltë për modernizimin e mëtejshëm të institucioneve tona dhe përafrimin e standardeve zhvillimore me BE-në, me ndikim të drejtpërdrejtë në avancimin e procesit të integritetit evropian të Shqipërisë.

Si mbështeste e procesit të zgjerimit Danimarka vlerëson ecurinë e reformave dhe progresin e arritur në Shqipëri, njëherësh me faktin që integrimi konsiderohet objektiv strategjik kombëtar.

Autoritet daneze e çmojnë lart rolin konstruktiv dhe lidërsipin aktiv të Shqipërisë në rajon. Nga ana tjetër, edhe linjëzimi i qëndrimeve të Shqipërisë me politikën e jashtme dhe të sigurisë së BE-së konsiderohet si një vlerë e qenësishme e politikës sonë të jashtme dhe orientimit tonë të qartë gjeopolitik.

Në suazën rajonale dhe si mbështetëse e perspektivës europiane të rajonit Danimarka i mëshon rëndësisë së avancimit të reformave të nevojshme për të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, pasi ato ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin ekonomik dhe përafrimin me standardet e BE-së.

Duhet nënvizuar qëndrimi veçanërisht mbështetës i Danimarkës ndaj Kosovës dhe në favor të integritetit ndërkombëtar të saj, po ashtu, është mbështetëse e dialogut Kosovë-Serbi, iniciuar nga BE-ja për normalizimin e marrëdhënieve mes dy vendeve.

Bazuar në këndvështrimin e mësipërm, në fokus të punës dhe veprimtarisë sime do të mbetet fuqizimi i dialogut të gjithanshëm politik me autoritetet e larta daneze në funksion të prezantimit progresiv të ecurisë së reformave për përafrimin e mëtejshëm me BE-në në dritën e zhvillimeve më të fundit për negociatat e pranimit me Shqipërinë në kuadër të Këshillit të Punëve të Përgjithshme, 26 qershor, dhe të Këshillit European të datës 28 qershor.

Gjithashtu, dimensionin parlamentar do të ketë vend të posaçëm në kuadër të dialogut politik, duke synuar aktivizimin e shkëmbimeve parlamentare, shkëmbim eksperiencash mes dy grupeve të miqësisë dhe komisioneve të ndryshme parlamentare.

Rritja e masës kritike në favor të njohjes së përparimit të Shqipërisë në rrugën europiane, por edhe një vështrim më nga afër të realiteteve në vend do të lidhet me qasjen për të kapitalizuar mbi pikëtakimet e shumta që na lidhin, veçanërisht fuqizimin dhe zgjerimin e mëtejshëm të rrjetit të miqve të Shqipërisë në Danimarkë dhe anasjelltas.

Bashkëpunimi ekonomik merr rëndësi të dorës së parë në nxitjen e shkëmbimeve mes dy vendeve. Pavarësisht se shifrat e vëllimit tregtar nuk janë inkurajuese do të vijojmë përpjekjet për prezantimin e potencialeve ekonomike dhe produkteve shqiptare në tregun danez përmes promovimit dhe nxitjes së kontakteve mes agjencive të specializuara, dhomave të tregtisë dhe mes bizneseve në të dy vendet.

Një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet tërheqjes së investimeve daneze në vendin tonë, bazuar në cilësinë dhe standardet e ekselencës që i karakterizojnë ato.

Duhet shënuar se nga një numër i papërfillshëm, tashmë në tregun tonë operojnë 35 kompani daneze, prezente në sektorë të ndryshëm, si energji, mjedis, transport, bujqësi etj.

Do të punohet në vazhdimësi si deri më tani për të mirëpritur investitorët danezë në sektorët strategjikë të vendit, siç janë energjia, nafta, turizmi, transporti, infrastruktura, zonat ekonomike dhe ato me përparësi zhvillimi. Përmes takimeve me aktorët relevantë do të evidentohen avantazhet tona, si për shembull ekzistenca e kuadrit të plotë ligjor, procedurat e lehtësuara dhe prania e AITA-s si një *single window* për investitorët strategjikë në funksion të rritjes së investimeve, por edhe të nxitjes së shkëmbimeve të gjithanshme dypalëshe do të synohet zgjerimi dhe pasurimi i kuadrit ligjor mes dy vendeve. Në këtë drejtim do të punohet për përfundimin e disa projekt marrëveshjeve në proces, me Danimarkën, në fushat e transportit detar, taksimit të dyfishtë, transportit ajror, ndihmës ligjore, bujqësisë dhe bashkëpunimit ndërmjet televizioneve.

Njëherësh, do të shihet edhe mundësia për lidhjen e akteve të reja, si një bazë e rëndësishme për institucionalizimin e bashkëpunimit në sektorë të ndryshëm.

Promovimi i potencialeve turistike dhe natyrore të vendit tonë si vektor i shumëfishtë për shkëmbimet ndërnjerëzore dhe nxitjen e imazhit të vendit, natyrshëm do të jetë drejtimi qendror i punës.

Duhet shënuar se, në sajë të angazhimit të deritanishëm, Shqipëria është përfshirë në destinacione turistike të tour-operatorëve danezë e skandinavë. Në kuadër të progresit të arritur me tour-operatorin “Apollo”, pritët të nisin fluturimet direkte Kopenhagen – Tiranë e anasjelltas për periudhën korrik-gusht, nga agjencia turistike daneze “Apollo”.

Pasqyrimi dhe shpalosja e vlerave unike të trashëgimisë sonë kulturore në Danimarkë, si vektor afrimi dhe si shëmbëlltyrë direkte e konstitucionit europian të Shqipërisë dhe të botës shqiptare, do të zërë një vend të konsiderueshëm në punën e ambasadës përmes organizimit të veprimtarive promovuese, vizitave, ekspozitave, organizimit të festës kombëtare e të tjerë.

Në këtë kontekst, bashkëveprimi i ngushtë me diasporën shqiptare të Danimarkës do të jetë në epiqendër të vëmendjes, në funksion të ruajtjes së rrënjëve identitare, lidhjet me atdheun, forcimit të mëtejshëm të urave të miqësisë, si dhe të bashkëpunimit midis dy vendeve. Po ashtu edhe mbrojtjes së e interesave konsullore të bashkatdhetarëve tanë me qëndrim në Mbretërinë e Danimarkës.

E nderuara zonja kryetare,

E nderuara zonja zëvendëskryetare,

Të nderuara zonja e zotërinj deputetë,

Para mbylljes dëshiroj të theksoj se nderin e posaçëm për të përfaqësuar Shqipërinë në një vend mik si Danimarka, do ta vendos me përkushtim maksimal dhe me të gjitha energjitë e mia, në funksion të thellimit të klimës dashamirëse të këtij vendi ndaj Shqipërisë, për forcimin e mëtejshëm të marrëdhënieve dhe bashkëpunimit me kah europian, si dhe të miqësisë shqiptaro-daneze.

Ju falënderoj shumë!

**Mimi Kodheli** – Faleminderit, ambasadore! Ju falënderoj për prezantimin dhe ju komplimentoj në lidhje me të.

Unë kam vetëm një pyetje, në dukje e thjeshtë, por që besoj se ha diskutim. Sigurisht, është një diskutim që nuk do ta shterojmë të gjithin sot këtu, por gjithsesi është një shqetësim që e ndjej jo vetëm unë, por edhe shumë anëtarë të këtij komisioni, e edhe më shumë se kaq.

Danimarka ka qenë një ndër vendet skeptike lidhur me proceset integruese dhe hapjen e negociatave të Shqipërisë me Bashkimin Europian. Si mendoni se brenda këtij viti të rëndësishëm, deri në hapjen e negociatave, në qershor të vitit që vjen, do të mund të intensifikohen marrëdhëniet midis vendit tonë dhe Mbretërisë së Danimarkës, me qëllim kthimin e Danimarkës nga një vend skeptik, në një vend promovuese e mbështetës të proceseve integruese të Shqipërisë?

**Elida Petoshati** – Faleminderit!

Danimarka, siç e theksova, në tërësi ka qenë mbështetëse e procesit të zgjerimit jo vetëm për Shqipërinë, por edhe për Ballkanin Perëndimor. Lidhur me progresin dhe ecurinë e reformave ka pasur një qëndrim të vëmendshëm, të kujdesshëm, të strukturuar ndaj ecurisë së tyre në funksion të hapjes së negociatave.

Për sa i përket vendimit të datës 28 qershor, ajo ishte një vendimmarrje kolektive, ku edhe Danimarka dha mbështetjen dhe pëlqimin bashkë me vendet e tjera, unanimisht, që të nisin negociatat e anëtarësimit në qershor të vitit të ardhshëm.

Për sa i përket pjesës së punës së ardhshme, që duhet bërë me autoritetet daneze, sigurisht që do të jetë në vëmendje parësore fuqizimi i partneritetit. siç e theksova në parashtrimin tim, veçanërisht në funksion të bërjes të njohur të ecurisë dhe progresit të reformave, në mënyrë që të rritet masa kritike në njohje të këtij progresi dhe të mbështetjes në vijimësi të këtij vendi që ka qenë gjithmonë mbështetës i perspektivës europiane të vendit tonë, që e ka dëshmuar përgjatë të gjithë viteve të tranzicionit demokratik. Çdo ndihmë zhvillimore dhe më gjerë që ka dhënë Danimarka ka qenë në funksion të përparimit europian, rrugës europiane të vendit.

Faleminderit!

**Ilir Xhakolli** - Ju dëgjova me vëmendje, ju thatë se një nga detyrat tuaja do të jetë edhe bashkëpunimi me diasporën shqiptare. Sa për t'u ndriçuar, a keni ndonjë informacion se sa mund të jetë ky numër?

**Elida Petoshati** - Shqiptarët në Danimarkë në tërësi kapin shifrën rreth 15 mijë qytetarë, janë disa nga Shqipëria dhe disa nga vendet e tjera, nga Kosova, nga shqiptarët e Maqedonisë, të Malit të Zi. Ata janë shumë të përfshirë në aktivitete kulturore, janë të angazhuar në shoqata, por mbi të gjitha duhet të evidentohet që janë të mirëintegruar dhe ruajnë një bashkëpunim shumë të mirë me ambasadën në funksion të ruajtjes së traditave dhe të kulturës. Në këtë sens do të vijojë puna, siç është bërë deri tani.

**Mimi Kodheli** – Po, zonja Gjoshë.

**Klajda Gjoshë** - Faleminderit, zonja Petoshati!

Ju dëgjova me vëmendje, në fakt doja të tërhiqja vëmendjen tuaj se qershori i vitit që vjen, nuk është data e çeljes së negociatave të Shqipërisë, por është data kur vendet anëtare do të rikonsiderojnë edhe njëherë mundësinë nëse do të çelin apo jo negociatat me Shqipërinë bazuar në kushtet, që ato i kanë vendosur shumë qartë. Unë e di se ndoshta në gjuhën tuaj ju përdorni diplomacinë, normalisht jeni pjesë e saj dhe do të duhet ta përdorni, por sa më të vërtetë të jemi me njëri-tjetrin aq më mirë do të ishte puna juaj si ambasadore e ardhshme e një prej vendeve jo vetëm më skeptike, por edhe më strikte në kuadër të shikimit me lupë apo analizimit që ato i bëjnë reformave që ndërmerr vendi ynë. Ndoshta kjo do t'ju ndihmonte më tej edhe në punën tuaj për sa i përket të gjithë angazhimit tuaj me përfaqësuesit e lartë në Danimarkë, të cilët do të shikoni se janë realisht, nuk do të thosha dhe aq konstruktivë, por janë shumë kërkues dhe do të duan rezultate konkrete. Besoj se duhet nisur nga këtu, për të qenë njëherë të sigurtë me njëri-tjetrin, për të thënë se Shqipërisë nuk i janë hapur negociatat dhe vitin që vjen ka një provim shumë herë më të vështirë se sa këtë radhë, duke qenë se nuk është vetëm Danimarka, por janë edhe shumë shtete të tjera, të cilat janë shumë herë më kërkuese ndaj Shqipërisë. Të mos harrojmë se ato kanë edhe zgjedhjet parlamentare të Parlamentit Europian, vitin që vjen të gjitha institucioneve europiane, gjë që e bën shumë herë më të vështirë një vendim për Shqipërinë për çeljen e negociatave në qershor të vitit 2019.

Faleminderit!

**Mimi Kodheli** - Po, zonja Hysi.

**Vasilika Hysi** - Faleminderit, zonja kryetare!

Uroj që zonja Petoshati të marrë besimin e Kuvendit të Shqipërisë. Unë kam një sugjerim, nëse ju do të merrni votën e Kuvendit të Shqipërisë duhet t'u jepni më shumë

rëndësi marrëdhënieve ndërparlamentare. Në fund të fundit janë parlamentet e këtyre vendeve që vendosin lidhur me faktin nëse Shqipëria ka bërë progres apo jo dhe i ka përmbushur të 5 kushtet. Më ka rezultuar, të paktën edhe nga takimet që kemi pasur ose nga informacionet që kërkojnë nga Kuvendi se shpesh nuk kanë informacionin e nevojshëm. Unë mendoj se krahas diplomacisë ekonomike, kulturore, turizmit e të tjerë një nga detyrat e vështira që kemi në kuadër edhe të hapjes së procesit të vlerësimit analitik të progresit që do të bëjmë në këta 12 muaj është shkëmbimi dhe bashkëpunimi më i mirë midis parlamenteve, por edhe informimi më i mirë me deputetët, qofshin edhe ata euroskeptikë. Ky është një sugjerim shumë miqësor, sepse edhe ne kemi miq në parlamentin danez, kolegë dhe një pjesë e mirë e tyre nuk kanë informacionin e duhur ose informacionin e kanë të shkurtuar.

Faleminderit!

**Mimi Kodheli** - Faleminderit, kolege e dashur, Vasilika!

Mendoj t'ia kaloj fjalën zonjës Hoxha, kandidate për ambasadore në Republikën e Bullgarisë, rezidente dhe jorezidente në Republikën moldave.

Të them të drejtën, përpara se t'jua jap fjalën, zonja Hoxha, do të doja të bëja një vëzhgesë. Sigurisht, ky është thjesht një opinion personal.

Në gjykimin tim, mbase do të ishte më e udhës që ambasadori jorezident në Republikën moldave të ishte ambasador rezident në Bukuresht, jo në Sofje.

**Gazmend Barbullushi** – Probleme politike...

**Mimi Kodheli** – Problemet politike midis dy vendeve ju bëjnë që...

**Gazmend Barbullushi** – Të bëj këtë zgjedhje.

**Mimi Kodheli** – Tërhiqem nga vëzhgesa.

Zonja Hoxha, fjala për ju.

**Donika Hoxha** – Përshëndetje!

E nderuara zonja kryetare,

Të nderuar deputetë,

Ndihem me të vërtetë e privilegjuar që gjendem sot përpara një audience të tillë të zgjedhurish (dhe ju falënderoj paraprakisht për vëmendjen), sikurse ndihem shumë e nderuar dhe e privilegjuar që jam propozuar për të përfaqësuar Shqipërinë në një vend tradicionalisht mik, si Bullgaria, në një vend që është i integruar në mënyrë të qëndrueshme në kuadrin euroatlantik, si në profilin institucional, ashtu edhe në atë të sigurisë, pasi është vend anëtar i NATO-s që në 2004-n dhe vend anëtar i Bashkimit Europian që në 2007-n, një vend, i cili zhvillon një politikë të jashtme të balancuar dhe realiste, të mbështetur në dialog, kompromis dhe paqe, që i jep një rëndësi të veçantë zhvillimit të marrëdhënieve me vendet e Europës

Juglindore, që i jep një rëndësi të veçantë stabilizimit dhe prosperitetit dhe perspektivës europiane të vendeve të Ballkanit Perëndimor, si dhe rritjes së marrëdhënieve me vendet e Detit të Zi.

Siç e tha edhe sekretari i Përgjithshëm pak më parë, Bullgaria mbajti kryesinë e radhës së Këshillit të Bashkimit European, që nga 1 janari deri më 30 qershor, duke e nisur këtë presidencë me një mbështetje të hapur të perspektivës së zgjerimit të Bashkimit European, duke përfshirë në planin e saj të veprimit edhe moton “Europa për të gjithë”, *“Europe for everyone”*.

Ndaj, i jemi mirënjohës Bullgarisë për këtë rol pozitiv që ka luajtur, por edhe për mbështetjen kyçe në mbledhjen e fundit të Këshillit, për vendimin që të ketë një datë dhe një perspektivë të qartë për Shqipërinë dhe Malin e Zi, për çeljen e negociatave.

Gjithashtu, i jemi po aq mirënjohës Bullgarisë edhe për mbështetjen dhe asistencën e përgjithshme që na ka dhënë, në kuadër të anëtarësimit tonë në NATO.

Puna ime dhe veprimi im diplomatik do të orientohet shumë nga vlerësimet e njëjta që kemi me Bullgarinë, në kuadër të anëtarësimit në Aleancë, për çështje të sigurisë rajonale, por edhe ato të përgjithshme.

Si Shqipëria, ashtu edhe Bullgaria, ndajnë të njëjtin mendim dhe të njëjtin vlerësim se politika e dyerve të hapura të NATO-s për vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor është shumë e rëndësishme dhe do ta nxisim Bullgarinë që të llojë edhe me vendet e tjera të NATO-s në këtë drejtim, sidomos tek institucionalizimi i marrëdhënieve me Kosovën. E falënderojmë Bullgarinë, pasi ka ende çështje të hapura të NATO-s në Ballkan, gjithashtu e vlerësojmë për mbajtjen në fokus të axhendës së këtyre dy organizatave të Ballkanit Perëndimor. Siç e thashë edhe pak më parë, marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Bullgarisë mbështeten në miqësi tradicionale, në kontakte historike, njerëzore, kulturore, të cilat datojnë që nga viti 1914. Pra, kanë kaluar më shumë se 100 vjet. Legata jonë e parë është hapur në Sofje në vitin 1922 dhe është mbështetur në të njëjta vlerësime dhe konsiderata. Marrëdhëniet janë zhvilluar në interes të dy popujve, në interes të rajonit, por edhe të perspektivës sonë europaine.

Ky vit përkon edhe me 25-vjetorin e nënshkrimit të Traktatit të Miqësisë me Bullgarinë, pra është nënshtruar në vitin 1993. Prej asaj kohe rezulton një dialog politik konstruktiv dhe i qëndrueshëm me Bullgarinë, i cili ka ardhur gjithnjë e në rritje. Pra, ka pasur një trend pozitiv. Ne ndajmë vlera pozitive të angazhimit demokratik me Bullgarinë si në aspektin e marrëdhënieve dypalëshe, ashtu edhe rajonale dhe shumëpalëshe.

Aksionin tim diplomatik, lidhjet dhe kontaktet e mia ndërpersonale në funksion të atyre ndërshtetërore do t'i drejtoja në këtë frymë, sikurse do të punoja fort edhe për një njohje

më të mirë të Shqipërisë në Bullgari, në mënyrë që të jetë në funksion të rritjes së bashkëpunimit, sidomos atij ekonomik.

Në vitet e fundit vihet re një rritje e bashkëpunimit ekonomik midis Shqipërisë dhe Bullgarisë. Po të kemi parasysh se vetëm në vitin e fundit kishim një rritje të eksporteve me 17% dhe një rritje të importeve bullgare me 24%. Bullgaria ka një pjesë të mirë në volumin tregtar brenda vendeve të BE-së me Shqipërinë, por kjo lidhje gjithsesi nuk reflekton nivel shumë të mirë të marrëdhënieve politike dhe të kontakteve midis njerëzve. Prandaj do të fokusohesha shumë në rritjen e bashkëpunimit ekonomik në tre drejtime: në rritjen e shkëmbimeve tregtare nëpërmjet promovimit; në promovimin e Shqipërisë si një destinacion për investimet bullgare; në identifikimin dhe çuarjen para të disa projekteve zhvillimore, që tashmë janë në fokus të dy vendeve tona. Sigurisht ne kemi të bëjmë me një gamë të gjerë, por do të fokusohesha shumë në nxitjen e projekteve të konjektivitetit, sidomos në fushën e energjisë, duke pasur parasysh dy elemente, që vëmendja jonë është shumë madhe për zhvillimin e këtij sektori në Shqipëri dhe unë jam shumë optimiste, duke pasur parasysh që Bullgaria është një ndër vendet më të rëndësishme në Ballkan si prodhuese dhe eksportuese e energjisë. Në këtë drejtim, linja e interkonjektivitetit të energjisë elektrike midis Shqipërisë, Maqedonisë dhe Bullgarisë do të ishte në fokus të , në mënyrë që të nxitet në realizimin e projektit, por jo vetëm. Edhe investimet në fushën e energjisë janë shumë të rëndësishme, pasi ne ofrojmë një potencial shumë të mirë dhe një kuadër rregullator shumë të mirë për investime.

Në këtë pikë investitorët bullgarë do të gjenin një terren shumë të mirë për të investuar në projekte për privatizimin e aseteve shtetërore ose në projekte të tjera për ndërtimin e HEC-ve të vogla apo edhe në projekte të ndryshme të energjisë së rinovueshme. Duke pasur parasysh edhe faktin që ekspertët ndikojnë shumë në rritjen ekonomike dhe në mirëqenien e njerëzve, një fokus të veçantë do t'i jepja eksportit. Ka pasur një trend në rritje, siç e thashë, por ai ka qenë më i vogël se importet bullgare, prandaj për mallra të tilla si druri, letra, lëkura dhe artikujt e lëkurës, që kanë pasur një shumëfishim gjatë viteve të fundit, të zgjerohen në gamë dhe me produkte të tjera. Mundësitë janë që ne të bëjmë një promovim të mirë të produkteve tona të ekselencës në Bullgari, i cili është një vend në rritje ekonomike (është vendi i tretë për sa i përket rritjes ekonomike në Bashkimin Europian), dhe ofron mundësi të mira dhe një taksim shumë të mirë. Gjithsesi, këto do t'i kombinoja fare mirë edhe me promovimin turistik, sepse jemi një vend pak i njohur në Bullgari. Nisur edhe nga pozicioni aktual që kam, si drejtor i Diplomacisë Publike, do të organizoja një fushatë *online* marketingu në Bullgari, të shoqëruar edhe me shumë evente të tjera promovuese të

koordinuara dhe të ndërlidhura me diplomacinë kulturore. Por një fokus të veçantë do t'i jepja edhe diplomacisë parlamentare, si një instrument shumë i mirë dhe alternativ i intensifikimit të marrëdhënieve mes parlamenteve, sidomos mes dy komisioneve atij të Jashtëm dhe atij të Integritetit. Prandaj kontaktet me ju, me parlamentin Bullgar dhe me komisionet përkatëse duhet të ishin shumë të shpeshta, në mënyrë që parlamenti Bullgar të lobonte edhe me vende të tjera të BE-së në këtë fazë testimi shumë të rëndësishme, që po kalojmë drejt çeljes së negociatave.

Me Bullgarinë kemi edhe një marrëdhënie shumë të mirë në kuadër të bashkëpunimit rajonal dhe Bullgaria dhe Shqipëria ndajnë të njëjtin vlerësim për sa u përket marrëdhënieve rajonale dhe të fqinjësisë së mirë. Bullgaria e tregoi këtë edhe me nënshkrimin e traktatit të miqësisë me Maqedoninë, me 2 gusht të vitit të kaluar, mes dy kryeministrave.

Në kuadër të nismës së procesit të bashkëpunimit të vendeve të Europës Juglindore, të Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal, ku patëm mbështetjen e Bullgarisë për kandidaturën e zonjës Majlinda Bregu, apo në kuadër të nismës së Europës Qendrore, mund të identifikohen edhe mënyra të reja bashkëpunimi, por mund të kërkohet edhe lobimi i Bullgarisë për mbështetjen e Kosovës, sepse ajo është një vend që e ka mbështetur Kosovën dhe brenda këtyre nismave të mbështesë përfaqësimin e saj, siç ndodhi edhe me mbështetjen që i dha për kryesimin e procesit të bashkëpunimit të vendeve të Europës Juglindore. Në këtë prizëm, marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Bullgarisë, në kuadër të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, ku ne ndajmë të njëjtën axhendë për sa i përket zbatimit të axhendës së vitit 2030 për SDG-të. Gjithashtu, ne jemi dy vende që synojmë fort respektimin e të drejtave të njeriut dhe në forcimin e ligjit dhe jemi palë në disa konventa të kësaj organizate. Në të njëjtën kohë, me Bullgarinë mund të identifikojmë mënyra bashkëpunimi për sa i përket mbështetjes së kandidaturave reciproke. Ne do të kërkojmë mbështetjen e Bullgarisë për mbështetjen e Shqipërisë në anëtarësimin në Këshillin e Sigurimit në vitet 2022 -2023 dhe veprimtaria diplomatike do të orientohet në forcimin e kontakteve dhe në promovimin sa më të madh të Shqipërisë në këtë drejtim. Gjithashtu, janë identifikuar edhe mundësi të tjera bashkëpunimi, brenda kësaj organizate, sikurse është edhe shkëmbimi i kandidaturave në bordin ekzekutiv të UNESCO-s.

Marrëdhëniet mes njerëzve janë ato që rrisin marrëdhëniet mes dy vendeve dhe diaspora shqiptare në Bullgari (sa do e vogël dhe sa do modeste) dhe komuniteti bullgar folës në Shqipëri janë dy komunitete që ndikojnë në rritjen e intensifikimit të marrëdhënieve, sepse janë dy kultura që zhvillohen brenda dy vendeve të ndryshme, duke nxjerrë në pah më shumë identitetin kombëtar dhe kulturor të një vendi në vendin tjetër. Diaspora shqiptare në Bullgari

është modeste dhe daton që në shekullin XVI. Ka pasur një përqendrim të shqiptarëve në shekullin XIX, kur Bullgaria u bë vatër e patriotëve shqiptarë, të cilët luftuan për kauzën shqiptare. Mund të përmend vetëm dy elemente...

**Mimi Kodheli** – Zonja Hoxha, nuk do t'i përmendni dy elementet, sepse koha juaj në dispozicion për të folur ka mbaruar. Këtu në Kuvend kemi disa rregulla strikte, të cilat i kemi mësuar për arsye të profesionit që kemi zgjedhur, na pritet fjala pavarësisht se mund të kemi gjëra të rëndësishme për të thënë. Kjo nuk do të thotë që unë do t'jua ndërpres fjalën, por mendoj se paraqitja juaj ishte më shumë se shteruese dhe ju komplimentoj për këtë gjë.

Me ligjin për respektimin e të drejtave të minoriteteve i kemi bërë një dhuratë të qenësishme Bullgarisë, sepse jo të gjithë guxojnë ta bëjnë këtë gjë me ne. Kështu që do t'ju ftoja ju që në atë pozicion që do të jeni të punoni dhe luftoni fort që pavarësisht se diaspora shqiptare mund të datojë nga shekulli XVI, gjithsesi mbetet një pjesë e atij vendi me prejardhje shqiptare dhe padyshim duhet të ketë, së pari, të drejta, të cilat me ligj ua sigurojmë minoriteteve bullgare në Shqipëri.

Unë kisha disa pyetje, të cilat ju i ezauruat me përgjigjet shteruese që dhatë.

Zonja Hysi, ka fjalën.

**Vasilika Hysi** – Faleminderit, zonja kryetare e komisionit!

Faleminderit, zonja Hoxha!

Ju dëgjova me vëmendje, por duke parë edhe CV-në tuaj, shoh se jeni fokusuar tek ajo diplomacia ekonomike, kryesisht te çështjet që lidhen me interkonjeksionin, investimet dhe bizneset, do të doja të ndalesha të çështja që përmendi edhe zonja Kodheli lidhur me minoritetin bullgar. Ne jemi ndër të paktat vende që kemi ligj për pakicat kombëtare, në këtë drejtim unë kam besimin e madh se do të jeni aktive, ashtu si edhe zonja Petoshati.

Gjithashtu, unë mendoj se do të ishte me vend fokusimi jo vetëm tek të drejtat e minoritetit, të cilat në Shqipëri respektohen, por edhe për të pasur një politikë më të kujdesshme në atë që quhet minoritet. Ju besoj e dini se jo të gjithë personat, që i përkasin këtij minoriteti, janë të pajisur me pasaporta bullgare. Besoj se kjo do të jetë në fokusin tuaj.

Së dyti, mendoj se edhe çështja e turizmit do të ishte një aspekt shumë i rëndësishëm. Me Bullgarinë jemi afër dhe mundësia për të pasur më shumë zhvillim të turizmit kulturor gjatë të gjithë vitit do të ishte një hapësirë edhe më e mirë.

Unë do t'ju uroj suksese dhe shpresoj që Kuvendi i Shqipërisë t'ju japë mandatin!

Gjithashtu, besoj se, si grua ambasadore, do të sillni një hop në marrëdhëniet diplomatike të vendit që ju përfaqësoni. Me gjithë respektin që kam për zotin Kurtezi, nuk

doja ta diferencoj, por sinqerisht më vjen mirë që raporti midis burrave dhe grave si ambasadorë po shkon në një drejtim të barazisë gjinore.

**Mimi Kodheli** – Nëse nuk ka ndonjë pyetje për zonjën Hoxha, do të kalojmë tek ambasadori Kurtezi.

Zoti Kurtezi, keni fjalën.

**Ridi Kurtezi** - Faleminderit!

E nderuar zonja kryetare!

Të nderuar kolegë të këtij komisioni, ndjem i vlerësuar të jem para jush në cilësinë e kandidatit për ambasador në Malin e Zi.

Më lejoni të konstatoj shkurtimisht aktualitetin e marrëdhënieve dypalëshe, si dhe objektivat e punës në rast se do të konfirmohem nga ju dhe Presidenti i Republikës.

**Marrëdhëniet politike**

Marrëdhëniet politike mund të vlerësohen shumë të mira, fqinjësore dhe si shembull i bashkëpunimit rajonal. Elementi thelbësor i qëndrueshmërisë dhe forcimit të tyre është fakti se midis dy vendeve nuk ka çështje apo problematika të hapura. Ekziston një përputhshmëri dhe ngjashmëri e prioriteteve kryesore të politikës së jashtme midis dy vendeve, që është integrimi europian, euroatlantik dhe bashkëpunimi i ngushtë rajonal.

Konfirmimi i nivelit të marrëdhënieve shumë të mira politike dhe i vullnetit për t'i zhvilluar më tej ato, është edhe vendimi i të dyja qeverive për të zhvilluar atë që quhet mbledhja e të dyja qeverive, e cila është parashikuar të mbahet nesër në qytetin e Shkodrës.

Bashkëpunimi ndërkufitar përbën një aspekt shumë të rëndësishëm të bashkëpunimit dypalësh, veçanërisht në kuadër të proceseve integruese dhe në kuadër të programeve IPA.

Synimi i punës sime do të jetë ruajtja dhe forcimi i mëtejshëm i nivelit të bashkëpunimit politik në interes të përbashkët dhe intensifikimi i kontratave politike, ndjekja dhe intensifikimi i punës në kuadër të implementimit të programeve ndërkufitare, me qëllim përmirësimin e jetës së banorëve të të dyja anëve.

**Marrëdhëniet ekonomike**

Rezultatet e bashkëpunimit ekonomik dypalësh nuk i përgjigjen nivelit të bashkëpunimit politik. Ekzistojnë të gjitha hapësirat për të rritur marrëdhëniet dhe shkëmbimet tregtare, pasi potencialet janë shumë më të mëdha. Ndaj, të dyja qeverive u takon të bëjnë më tepër për heqjen e barrierave.

Shkëmbimet tregtare vlerësohen të jenë rreth 40 milionë euro. Tematika e bashkëpunimit ekonomik pritet të diskutohet gjerësisht nesër, në takimin e dy qeverive në

Shkodër, ku do të ketë edhe një forum biznesi me pjesëmarrjen e dhomave të tregtisë dhe agjencive të investimeve.

Synimi i punës sime do të jetë funksionimi i rregullt i strukturave, mekanizmave dhe bazës ligjore në funksion të rritjes dhe forcimit të bashkëpunimit ekonomik, zhvillimi i takimeve të komisionit të përbashkët ekonomik, intensifikimi i bashkëpunimit në fushën e transportit, energjetikës dhe turizmit, përmirësimi i bashkëpunimit në projektet “Cross Border” dhe kryesisht ato për shfrytëzimin e pasurive të përbashkëta ujore në liqenin e Shkodrës, lumin e Bunës dhe atë të Cemit.

#### Kuadri ligjor

Ndërmjet dy vendeve ka një kuadër të mirë ligjor, por ka edhe një sërë fushash, të cilat kanë nevojë të mbulohen me marrëveshje respektive. Vlerësoj, gjithashtu, se ka vështirësi në zbatimin e disa marrëveshjeve, ndaj, synimi në punën time do të jetë implementimi i atyre ekzistuese dhe puna për hartimin dhe nënshkrimin e disa marrëveshjeve të tjera dypalëshe, si ajo e punësimit sezonal, njohja reciproke e diplomave, marrëveshjet për hapjen e pikave të reja kufitare, marrëveshjet për ndihmën gjyqësore.

Element shumë i rëndësishëm në marrëdhëniet dypalëshe është faktori shqiptar. Ai është një element thelbësor në marrëdhëniet dypalëshe, ka qenë vendimtar në arritjen e pavarësisë së Malit të Zi dhe integritit të vendit në NATO. Rezultati i ngushtë pro opsionit të pavarësisë në referendumin e vitit 2006 u arrit në saj të votës së shqiptarëve. Ndërkohë që kemi këtë kontribut faktik, perceptimi i vetë shqiptarëve në pozicionin në shtet dhe në shoqëri, është jo shumë pozitiv. Janë mohuar shumë zhvillimet pozitive në drejtim të realizimit të të drejtave të tyre kushtetuese. Është fakt se faktori shqiptar ka pritshmëri më të mëdha për sa u përket sasisë, cilësisë dhe shpejtësisë së procesit të realizimit të të drejtave të tyre, si dhe zhvillimit ekonomik, social dhe kulturor në zonat e banuara nga shqiptarët.

Subjektet politike shqiptare kanë qenë dhe janë pjesë e të gjitha koalicioneve qeverisëse në Malin e Zi, por rezultatet e pjesëmarrjes së vazhdueshme në qeveri ende lënë vend për përmirësim.

Zbatimi i marrëveshjes aktuale të bashkëpunimit në qeverisje ndërmjet DPS-së në pushtet dhe koalicionit shqiptar të vendosur, kërkon ritme më të shpejta, megjithëse ka pasur afate të përcaktuara. Ndër arritjet kryesore evidentohet përcaktimi i statusit të komunës së pavarur të Tuzit dhe miratimi i planit hapësinor të komunës së Ulqinit.

Synim në punën time, për sa u përket faktorëve shqiptarë, do të jetë rritja e interesimit dhe vëmendjes së shtetit dhe institucioneve tona për respektimin e të drejtave të pakicës shqiptare në Malin e Zi.

Diskutimi i problematikave të pakicës shqiptare në Malin e Zi dhe të gjitha takimeve dypalëshe me autoritetet malazeze. Standardizimi i të drejtave kushtetuese të pakicës shqiptare me pakicat e tjera ekzistuese, si boshnjake dhe kroate, puna me faktorin politik shqiptar në Malin e Zi, për të ndihmuar në forcimin e bashkëpunimit brenda shqiptarëve dhe ndërmjet subjekteve politike shqiptare, duke zbehur konfliktualitetin dhe duke inkurajuar përgjegjshmëri.

Dëshiroj që në përfundim të fjalës sime t'ju siguroj se, nëse do të konfirmohem ambasador nga ju dhe Presidenti i Republikës, do të punoj me angazhim, përkushtim, profesionalizëm dhe energji për të përmbushur objektivat që parashtrova, por edhe të tjera, që Ministria e Jashtme dhe institucione të tjera të larta do të më ngarkojnë.

Ju faleminderit!

**Mimi Kodheli** – Faleminderit, zoti ambasador!

Kisha dy pyetje për ju, pastaj do t'ia lë fjalën ish-ministres Gjoshaj për komentin.

E para. A mendoni ju se stafi i ambasadës që ju do të drejtoni është i mjaftueshëm? E ngre këtë pyetje, sepse e kuptoj që është problematikë buxheti, administrimi, por përtej kësaj mendoj se në të gjitha vendet, jo vetëm në Malin e Zi, ku ka një prezencë të konsiderueshme shqiptarësh etnikë, që jetojnë në trojet e tyre, do të duhej të kishte më shumë staf mbështetës. Gjithçka që ju me të drejtë përmendët cekët si çështje, të cilat kërkojnë zgjidhje, zhvillim apo mbështetje nga ana e punës suaj dhe nga ana e punës së qeverisë shqiptare, pse jo edhe të faktorit shqiptar në të dyja anët e kufirit, do të kishte nevojë për më shumë staf mbështetës për t'u marrë këto çështje. Ky është një problem që unë e kam shtruar edhe për stafin e ambasadës sonë në Shkup dhe më gjerë se kaq.

E dyta, e cila është më shumë retorike, por gjithsesi e shikoj të nevojshme për ta bërë. Kur ne kalojmë kufirin për të kaluar fundjavën, pushimet apo edhe tranzit nga Shqipëria në Malin e Zi, ka shumë makina që largohen, sepse shumë shqiptarë pushojnë atje. Por nuk është e njëjta gjë për malazezët që mund të vijnë në Shqipëri, megjithëse gjithkush prej nesh e di sesa i bukur është bregdeti malazez. Investimet në turizëm datojnë që herët në këtë vend, pra në një periudhë kur ne ishim ende një vend totalisht i izoluar. A mendoni ju se falë punës suaj, por jo vetëm, sepse duhet të jenë shumë aktorë dhe faktorë që duhet ta bëjnë këtë punë, promovimi, siç e përmendi më shumë se një herë edhe zonja Hoxha, i Shqipërisë dhe i turizmit do të mundësonte që radhët të mos ishin vetëm në dalje me shqiptarë, por të ishin në hyrje me malazezë?

Faleminderit!

Fjala për zonjën Gjoshaj.

Më pas mund të përgjigjeni ju.

**Klajda Gjosh**a – Faleminderit, zoti Kurtezi!

Do të doja ta vlerësoja kandidaturën tuaj për ambasador në Malin e Zi. Realisht, e vlerësoj eksperiencën tuaj si ambasador i mëparshëm në Mbretërinë e Spanjës, i cili ka qenë një vend që ka luajtur një rol mjaft të rëndësishëm për procesin e integritetit të Shqipërisë, ku ne kemi kryer edhe disa takime në Spanjë për të lobuar, por edhe për t'i bindur në fund të fundit që Shqipëria duhet të ecte përpara në këtë proces.

Ju ishit mjaft i zgjeruar në detaje në prezantimin tuaj, prandaj nuk do të doja t'i përsërisja gjërat, por doja vetëm t'ju tërhiqja vëmendjen, pasi Ministria e Integritetit e asaj kohe, deri para një viti, ka kryer disa takime të njëpasnjëshme me ministrin e Punëve të Jashtme, apo Ministrinë e Integritetit të Malit të Zi, sepse tashmë kanë një ministri të krijuar posaçërisht për procesin e negociatave dhe ky ishte një shkëmbim i jashtëzakonshëm eksperiencash. Kjo ka funksionuar në bazë të një marrëveshjeje që ne kemi lidhur para 4 vjetësh.

Unë do të doja që të vazhdonim me takime të tilla, sepse gjatë vitit të fundit nuk kam parë që Shqipëria të ketë pasur takime me qeverinë e Malit të Zi për të diskutuar, për të ndërmarrë apo për të shkëmbyer eksperiencën për procesin e negociatave. Unë mendoj se ne kemi shumë për të mësuar nga ai vend, sepse është një vend që ka çelur mbi 30 kapituj, pavarësisht se sa ka mbyllur, por eksperiencën e ka shumë herë më të konsoliduar sesa ne. Ndaj dua që këto takime të vazhdonin dhe nëpërmjet jush t'i tërheq vëmendjen Ministrisë së Punëve të Jashtme të Europës.

Faleminderit!

**Mimi Kodheli** - Fjalën e ka zonja Hysi.

**Vasilika Hysi** – Faleminderit, zoti Kurtezi!

Unë mendoj, se nëse ju do të merrni besimin e Kuvendit për të qenë ambasador i Republikës së Shqipërisë në Malin e Zi, keni një sërë detyrimesh dhe angazhimesh që duhet t'i përmbushni.

Unë nuk dua të përsëris atë që me të drejtë e përmendi kryetarja e komisionit, reciprocitetin, nevojën e vendosjes së marrëdhënieve jo vetëm në fushën ekonomike, kulturore, por edhe në shumë fusha të tjera, duke e vënë theksin te promovimi i projekteve ndërkufitare. Unë dua të theksoj se minoriteti malazez në Shqipëri është një urë shumë e mirë bashkëpunimi, e cila është evidentuar gjatë gjithë kësaj periudhe, por edhe gjatë diskutimit të projektligjit, që tashmë është ligji për pakicat dhe, të akteve nënligjore, që po përgatiten nën kujdesin e Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme. Ata kanë qenë shumë aktivë dhe

shumë dashamirës, që do të thotë se ajo frymë e mirë bashkëpunimi, që me të drejtë zonja Hoxha tha se bashkëpunimi fillon midis njerëzve dhe pas ngrihet në nivelin e qeverive dhe shteteve, të ekzistojë edhe me Malin e Zi.

Së dyti, dua t'ju inkurajoj fort për të nxitur të gjithë operatorët turistikë, që siç operatorët shqiptarë çojnë grupe turistike në Mal të Zi, edhe operatorët turistikë të Malit të Zi të kenë në axhendën e tyre, qoftë edhe me paketat që ka hartuar qeveria, edhe Shqipërinë.

Besoj se më mirë se kushdo tjetër diplomacia ekonomike, përfshirë edhe turizmin, do të ishte parësore në veprimtarinë tuaj, duke përdorur edhe minoritetin si një urë shumë e mirë bashkëpunimi, e cila kishte një vlerësim të jashtëzakonshëm, qoftë për ligjin, për pakicat kombëtare, por edhe për procesin që ministria juaj po zhvillon për aktet nënligjore.

Ju uroj suksese dhe uroj që të tre të merrni besimin e Kuvendit të Shqipërisë!

Faleminderit!

**Mimi Kodheli** – Zoti Ambasador, fjala për ju, por do t'ju lutem sa më shkurt! Jepni një përgjigje për një pyetje dhe një përgjigje tjetër për të tria pyetjet e tjera, sepse ne deputetët jemi pak a shumë në të njëjtën valë, ndërsa ju ministrat jeni në një valë tjetër..

Urdhëroni!

**Ridi Kurtezi** - Në lidhje me stafin e përfaqësive diplomatike, mendoj se stafi është i mjaftueshëm. Ndoshta mund të bëhet më shumë, duke ofruar staf teknik, i cili, në shumë praktika ndërkombëtare, ndihmon stafin diplomatik. Pra, një mundësi është fuqizimi i stafit teknik.

**Gazmend Barbullushi** – Për ne, si Ministrie e Jashtme, është prioritet fuqizimi i rrjetit të ambasadave në rajon. Ne atje kemi një ambasadë 1+3 dhe hyn tek ambasadat relativisht të mëdha.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Për momentin kemi disa prioritete, por kemi edhe shumë kufizime në buxhet dhe në numër. Por Mali i Zi hyn tek ato ambasada që duam ta shtojmë stafin sa më shpejt të jetë e mundur.

**Mimi Kodheli** – Zoti Barbullushi, na jepni kërkesat konkrete, komisioni ka shumë dëshirë, që t'ju mbështesë në buxhet, duke vënë nën presion qeveri që të ketë më shumë buxhet.

**Gazmend Barbullushi** - Së shpejti do t'ua paraqesim dhe do t'ju jemi shumë mirënjohës.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Mimi Kodheli** – Urdhëroni!

**Ridi Kurtezi** - Në lidhje me konstatimin tuaj për turizmin dhe shkëmbimin e turistëve, është e vërtetë që më shumë turistë shkojnë nga Shqipëria atje. Ndoshta, kjo ka bërë më shumë me punën që do të bëjmë ne për promovimin e turizmit, operatorët turistikë këtu apo me agjencitë e turizmit atje. Pra, duhet të punojnë edhe në këtë drejtim.

Në lidhje me konstatimin e zonjës Gjoshë, jam i vetëdijshëm dhe kam informacionin e duhur për takimet që keni pasur dhe për marrëveshjen që keni bërë. Mendoj se Mali i Zi është një shembull shumë i mirë jo vetëm që ka hapur rreth 30 kapituj, por edhe i ka përfunduar 2-3 kapituj. Mendoj se ka hapësirën e nevojshme për të bashkëpunuar edhe në këtë drejtim.

**Mimi Kodheli** – Faleminderit, zoti Kurtezi!

Zoti Barbullushi, në qoftë se nuk ka gjë tjetër, besoj se ne kemi marrë informacionin e duhur lidhur me prezantimin e tre kandidatëve për ambasadorë. Dua t'ju falënderoj për seriozitetin dhe për paraqitjen. Shpresoj të shihemi nesër me prezantimin e 3 apo 4 ambasadorëve të tjerë.

Faleminderit dhe punë të mbarë!

Shihemi nesër në orën 12:00.

## **MBYLLET MBLEDHJA**